



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 1366 prot

Korçë, më 01 / 08 / 2019

VENDIM

Nr. 421, datë 01 . 08 2019

PËR

**MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR ÇDO
PROGRAM STUDIMI PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020**

Mbështetur, në VKM nr. 288, datë 21.05.2018, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", në VKM nr. 866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", si dhe në VKM nr. 778, datë 26.12.2018, "Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, pika 1 gërma a), urdhërit të MASR nr.416 datë 29.7.2019 si dhe referuar vendimit të Senatit Akademik nr 415, datë 30.7.2019, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 31.7.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për vitin akademik 2019-2020 për programet e ciklit të parë, për programet e ciklit të dytë dhe programet profesionale të studimit të njëjta me vitin akademik 2018-2019, sipas listës bashkëlidhur.
2. Të miratojë tarifën e programit të ri "Edukim fizik dhe sporte" për program të parë në vlerën 20,000 lek dhe për program të dytë në vlerën 111,812 lek.
3. Të miratojë tarifat të regjistrimit paraprak 1,600 lek për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe programet profesionale, 2,500 lek për të gjitha programet e studimit Master, dhe 3,000 lek për të gjitha programet e dyta të studimit.

4. Të miratojë tarifën e regjistrimit për konkursin e pranimit në programin “Edukim fizik dhe sporte” në vlerën 5,000 lek.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof.as.dr. Mamica Nene

REP/16